

**Klubi i sporteve të ujit OTRILA,  
Prishtinë - Kosovë  
(K.S.U. OTRILA)**

**PASQYRAT FINANCIARE**

**Për periudhën prej 1 janar 2021 deri në 31 dhjetor 2021**

(me raportin e auditorit të pavarur mbi të)

Prishtinë, 31 Maj 2022

## **Përmbajtja**

## **Faqe**

Raporti i Auditorit të Pavarur

Identifikimi

Pasqyra e pozitës financiare

1

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve gjithëpërfshirëse

2

Pasqyra flukseve të parasë

3

Shënimet e pasqyrave financiare

4-11

### **Shtojca 1**

1. Kontrata për sponsorizim me Spitali OTRILA Sh.P.K. Prishtinë

12

2. Kontrata për sponsorizim me "AUTO MITA R" SHPK

13



## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

### **Për Kryetarin e Klubit të sporteve të ujit OTRILA Prishtinë - Kosovë**

#### **Opinionit**

Ne kemi audituar pasqyra financiare të Klubi i sporteve të ujit OTRILA, Prishtinë - Kosovë (K.S.U. OTRILA ose Klubi), të cilat përmbajnë pasqyrat e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2020, dhe me datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e flukseve të parasë për vitin për vitin/et që mbyllen me këto data, dhe shënimet në pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin me korrektësi, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë - Kosovë më datën 31 Dhjetori 2021, dhe të performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që përfundon me këtë datë, në përputhje me politikat dhe procedurat e kontabilitetit të shpalosura në Shënimin 2 të pasqyrave financiare shoqëruese.

#### **Baza për Opinionin**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e raportimit financiar dhe kontrollin e tillë që menaxhmenti përcakton është i domosdoshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë të lira nga gabimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuideojë Organizatën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Klubit.

---



### **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Klubit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Organizatës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Klubi të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjen, nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrihet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

**"Balluku & Zhaveli" Prishtinë**

**Tomorr ZHAVELI**  
Auditor Ligjor

Prishtina, 31 Maj 2022

## **Identifikimi**

### **1.1 Caktimi i Auditimit**

<b>Klienti:</b>	<b>Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtine - Kosovë</b>  <b>Habibe Musa</b> , Kryetare e klubit Rr. Ukshin Kovaçica, Hyr.1 Nr.37 Mati 1 10000 Prishtinë, Kosovë Tel.: +383/44185999 Adresa elektronike: ksuotrila@kosovo-asf.org
<b>Kontraktori:</b>	<b>N.Sh. "Balluku &amp; Zhaveli", Ortakëri e përgjithshme</b> Tomorr Zhaveli, Auditor Ligjor Agim Ramadani 36/13 10000 Prishtina Kosova Kosova Tel.: + 383 44 500 421 Adresa elektronike: <b>tzhaveli@yahoo.com</b>
<b>Detyra</b>	<b>Auditmi i pasqyrave financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2021</b>

---

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë - Kosovë

## Pasqyra e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

<b>Me 31 Dhjetor</b>	<i>Shënime</i>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor 2020</b>
<b>Pasuritë</b>			
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Parat e gatshme dhe ekuivalente te saj	3	4,589	1,333
Parapagimet	4	-	8,000
Kërkesat për sponsorizime	5	117	667
<b>Gjithsej pasuria afatshkurtër</b>		<b>4,666</b>	<b>10,000</b>
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Automjetet	6	21,887	-
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>21,887</b>	-
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>26,553</b>	<b>10,000</b>
<b>Detyrimet</b>			
<b>Detyrimet afatshkurta</b>			
Llogarite e pagueshme	7	-	2,000
Të pagueshme te tjera	8	3,362	-
Të hyrat shtyra	9	4,400	8,000
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurta</b>		<b>7,762</b>	<b>10,000</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>7,762</b>	<b>10,000</b>
<b>Fond Balanca</b>	10		
Fondi i organizatës me		-	-
<b>Teprica / (mungesat) e vitit</b>		<b>18,791</b>	-
<b>Net fond balanca</b>		<b>18,791</b>	-
<b>Gjithsej Fondet</b>		<b>18,791</b>	-
<b>Gjithsej fond balanca dhe detyrimet</b>		<b>26,553</b>	<b>10,000</b>

Autorizuar nga menaxhimi me \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
**Znj. Habibe Musa**

Kryetare i K.S.U. OTRILA

\_\_\_\_\_  
**Z. Ersan Hamdiu**

Menaxher i Klubit/ Financier

Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

**Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve gjithëpërfshirëse për vitin që përfundon me: 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat në Euro)*

	<b>Për periudhën që përfundon me</b>		
	<i>Shënime</i>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor -2020</b>
<b>Te hyrat/ Financimet</b>			
Të hyrat nga Donacionet/ Subvencionet		5,500	3,910
Të hyrat nga Sponsorët		23,450	667
Të hyrat tjera		-	-
<b>Gjithsej të Hyrat</b>	<b>11</b>	<b>29,000</b>	<b>4,577</b>
<b>Shpenzimet</b>			
Shpenzimet e personelit		-	-
Shpenzimet e aktiviteteve		(7,346)	(4,349)
Shpenzimet operacionale dhe administrative		(280)	(228)
Shpenzimet e zhvlerësimit		(1,563)	-
Shpenzimet tjera		(1,020)	-
<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	<b>12</b>	<b>(10,209)</b>	<b>(4,577)</b>
<b>Fitimi/(Humbja)</b>		<b>18,791</b>	<b>0</b>

Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Pasqyra e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

Për vitin që mbaron me 31 Dhjetor	2021	2020
<b>Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi/(humbja) neto për vitin	18,791	
<i>Rregullimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>		
Zhvlerësimi	1,563	
(Rritjet)/Zvogëlimet në llogarit e arkëtueshme	550	(667)
(Rritjet)/Zvogëlimet e llogarit tjera te parapagimeve	8,000	(8,000)
(Rritjet)/Zvogëlimet e llogarit e pagueshme	(2,000)	2,000
(Rritjet)/Zvogëlimet e detyrimet tjera	3,361	-
(Rritjet)/Zvogëlimet e te ardhurat e shtyra	(3,600)	8,000
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>26,666</b>	<b>1,333</b>
<b>Rrjedha e parasë prej aktivitetet investuese</b>		
Shtesa në pasurit afatgjata	(23,450)	-
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>(23,450)</b>	<b>-</b>
<b>Neto Rritjet/(zvogëlimet)</b>	<b>3,216</b>	<b>1,333</b>
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë së gatshme në fillim të vitit	1,333	0
<b>Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë së gatshme në fund të vitit</b>	<b>4,549</b>	<b>1,333</b>

Shënimet shoqëruese janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave



# **Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë**

## **Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021**

*(Vlerat në Euro)*

---

### **1. TË PËRGJITHSHME**

Klubi i Sporteve të ujit OTRILA është regjistruar si Organizatë Joqeveritare, në bazë të nenit 9 Ligji Nr. 04/L-57. Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës, me numër regjistrimit 5115667-6 dhe me emër të plotë "Klubi i Sporteve të ujit OTRILA". Data e regjistrimit 23/07/2015.

Selia e Klubit është në Rr. Ukshin Kovaçica, Hyr.1 Nr.37 Mati 1, 10000 Prishtine.

#### **Qëllimi**

Klubi është themeluar me qëllim të :

Trajnoj sportiste te rijnë, të mbjell dashuri për sportet e ujit, të rrit vetëbesimin, të zhvilloj bashkëpunimin ekipor, dhe të krijoj një mjedis optimal, i cili mundëson te gjithë sportisteve, si atyre fillestar, ashtu edhe atyre të avancuar, që të kenë mundësi të barabarta për të mësuar, përmirësuar dhe përmbushur potencialin e tyre maksimal.

Për ti përmbushur qëllimet e saj, Klubi nuk ndërmerr këto lloje të aktiviteteve:

- Trajnime dhe aftësime të sportisteve te sporteve të ujit,
- Promovimin e sportit te ujit,
- Stërvitje personale dhe ekipore,
- Avancime profesionale te sportisteve,
- Trajnime e trajnerëve dhe reverëve,
- Merr pjesë aktivisht në manifestime dhe gara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Klubi është themeluar nga themeluesit :

1. Mentor Bajrami
2. Fitore Halili
3. Habibe Musa
4. Ersan Hamdiu

Përfaqësues i autorizuar i organizatës është:

Ersan Hamdiu

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

---

### **2. BAZA E PREZANTIMIT DHE PËRMBLEDHJA E PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

#### **2.1. BAZA E PREZANTIMIT**

Pasqyrat shoqëruese financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përgatitur me qëllim të veprojnë në përputhje me qëllimin e Klubit, dhe të jenë një prezantim i plotë i fondeve, granteve, sponsorizimeve dhe subvencioneve dhe të hyrave tjera të pranuar nga Organizata, të ardhurave dhe shpenzimeve.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve është shprehur në euro, në të cilën janë konvertuar gjitha monedhat e përdorura nga Organizata në operacionet e saj. Pasqyrat shoqëruese e të ardhurave dhe shpenzimeve është e përgatitur në bazë e akruale të kontabilitetit.

#### **2.2. PERMBLEDHJA E PARIMEVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

Një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare është paraqitur më poshtë:

##### **2.2.1. Konventat e Kontabilitetit**

Raporti financiar është përgatitur nga Klubi i cili mban shënimet kontabël në Excel. Politika e Klubit është që të përgatisë pasqyrën shoqëruese të hyrave dhe shpenzimeve në parimin aktual. Bazuar në këtë, të ardhurat njihen në momentin kur ndodhin në vend se kur pranohen, dhe shpenzimet njihen kur ndodhin jo kur paguhen.

Për qëllim të raportimit janë bërë shpalosjet e nevojshme për të plotësuar kërkesat për raportim tek MKRS për Sponsorizimet e pranuar nga Klubi.

##### **2.2.2. Monedha raportuese**

Fondet janë marrë në euro, ndërsa shpenzimet janë të qëndrueshme në valutë Euro (monedhe e Kosovës). Raporti financiar është shprehur në Euro, në të cilën është paraqitur në monedhat e përdorura nga Projekti në operacionet e saj. Transaksionet në valuta të tjera jo euro janë përkthyer në euro me kursin përkatës të këmbimit në datën e transaksionit.

##### **2.2.3. Tatimet**

Në përputhje me aktivitetin që i realizon Klubi si OJQ është e liruar nga tatimi mbi fitimin. Pagesat ndaj personelit dhe pagesat ndaj personave fizik ngarkohen me taksë dhe kontributin pensional mbi të ardhurat në bazë të Rregulloreve të aplikueshme në Kosovë.

##### **2.2.4. Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë parat dhe depozitat bankare afatshkurtra me maturim prej tre muajsh ose më pak.

##### **2.2.5. Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera**

Arkëtueshmet janë deklaruar në vlerën neto të realizueshme të tyre.

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

---

### 2.2.6. Prona dhe Pajisjet

Prona dhe pajisjet mbahen me kosto, minus zhvlerësimin e akumuluar. Të gjitha pajisjet kapitalizohen si Pasuri dhe jo shpenzime. Zhvlerësimi është dhënë në një bazë lineare në normat e mëposhtme:

	In %
Automjetet	20
Mobilet	20
Pajisjet	20

### 2.2.7. Detyrimet

Detyrimet paraqesin shumat në lidhje me shpenzimet e njohura në baza akruale. Detyrimet janë paraqitur me vlerën e kostos së tyre. Në 31 Dhjetor 2021, detyrimet e mbetura lidhen me detyrimet e FNK dhe palëve të ndërlidhura me operacionet.

### 2.2.8. Të hyrat e shtyra

Të hyrat e shtyra janë fondet e pranuar nga donatoret apo sponsoret të pa shpenzuar në periudhën raportues dhe njihen si të hyra deri në nivelin e shpenzimeve e ndërlidhura me këto të hyra specifike / të kontraktuara.

### 2.2.9. Të ardhurat

Fondet e marra janë përfituar nga Donatore te ndryshëm përmes subvencioneve dhe Kontratave për sponsorizime, këto të hyra njihen si të ardhura kur pranohen, respektivisht kur shpenzohen.

**COVID-19:** Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Kosovë dhe globalisht ka rezultuar në supozime dhe vlerësime që kërkojnë rishikime të cilat kërkojnë rregullime materiale të vlerës bartëse të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti, menaxhmenti pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e pasurive të patrupëzuara, pronës dhe pajisjeve, pasurive me të drejtë përdorimi, llogarive të arkëtueshme dhe të arkëtueshme tjera, huamarrjeve, llogarive të pagueshme dhe të pagueshme tjera dhe vlerës së tyre bartëse mund të kërkoj korigjim.

Mirëpo, në këtë fazë udhëheqësja e klubit nuk është në gjendje të vlerësojë në mënyrë të besueshme ndikimin pasi ngjarjet po vazhdojnë të rrjedhin edhe në vitin e dytë të ndikojnë në numrin e aktiviteteve të parapara sportive.

Ndikimi afatgjatë mund të ketë ndikim edhe në të ardhurat, flukset e parave dhe profitabilitetin. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Klubi vazhdon të përmbushë detyrimet e t'ia dhe vazhdon të zbatojë bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare sipas parimit të vijimësisë, duke u mbështetur në të hyrat e kontaktuar dhe të zotuar nga FHK, KK Prishtine, MKRS dhe Sponsoret të cilët mundësojnë që Klubi të zhvilloj aktivitetet sportive.

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

### 3. PARATE NË DORË DHE BALANCAT BANKARE

Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë janë detajuar si më poshtë:

Deri me 31 Dhjetor	31 dhjetor 2021	31 dhjetor, 2020
NLB -XK051185005681000182	4,549	1,204
Arka	0	130
<b>Gjithsej</b>	<b>4,549</b>	<b>1,333</b>

### 4. PARPAGIMET

Parapagimet janë pagesa për blerjen e automjetit Kombi për nevojat e Klubit (Shih Aneksin 1).

Deri me 31 Dhjetor	31 dhjetor 2021	31 dhjetor, 2020
Auto Mita	0	8,000
<b>Gjithsej</b>	<b>0</b>	<b>8,000</b>

### 5. KËRKESAT NGA DONATORET/ SPONSORET

Deri me 31 Dhjetor	31 dhjetor 2021	31 dhjetor, 2020
Sponsoret	117	667
<b>Gjithsej</b>	<b>117</b>	<b>667</b>

Kërkesat për sponsorizim paraqet vlerën e kërkesave sipas kontratës me "AUTO MITA" SHPK të raportuara si shpenzime të ndodhura në vitin 2020 e të ndërlidhura me kontratën me Sponsorin AUTO MITA të paguara/pranuara në vitin 2021.

### 6. Pasurit afatgjata - automjetet

	Automjetet	Gjithsej
<b><u>Kostoja</u></b>		
Me 01 janar 2021	0	0
Shtesat gjatë vitit	23,450	<b>23,450</b>
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>23,450</b>	<b>23,450</b>
<b><u>Zhvlërësimi i akumuluar</u></b>		
Me 01 janar 2021	0	0
Shtesat gjatë vitit	(1,563)	<b>(1,563)</b>
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>(1,563)</b>	<b>(1,563)</b>
<b>Vlera neto</b>		
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>21,887</b>	<b>21,887</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Me datën 25 gusht 2021 Klubi ka pranuar automjetin Renqult Traffic Passenger Zen dci 110 (Faktura nr 21-SHV01-IM4-490 dt. 25.gusht 2021, në vlerë prej 23,450 Euro i cili është regjistruar në emër të Klubit. Në evidencën kontabël është raportuar si Pasuri afatgjate – automjet dhe të zhvlërësohet sipas normës prej 20% në vit.

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

### 7. TE PAGUESHMET

Të pagueshmet janë të përbëra si më poshtë:

<b>Deri me 31 Dhjetor</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor, 2020</b>
Detyrimet ndaj furnitorëve	-	2,000
<b>Gjithsej</b>	<b>-</b>	<b>2,000</b>

### 8. TË PAGUESHMET TJERA

Të pagueshmet tjera janë të përbëra si më poshtë:

<b>Deri me 31 Dhjetor</b>	<b>31 dhjetor 2021</b>	<b>31 dhjetor, 2020</b>
Detyrimet tjera	3,361	-
<b>Gjithsej</b>	<b>3,361</b>	<b>-</b>

### 9. TË HYRAT E SHTYRA

<b>Donatori/ Sponsor</b>	<b>Të hyrat e shtyra nga 2020</b>	<b>Të pranuarat /njohura në 2021</b>	<b>Të njohura në 2021</b>	<b>Të hyrat e shtyra me 31 Dhjetor 2021</b>
Otrila	8,000	8,000	(16,000)	-
Auto Mita R	-	8,000	(8,000)	-
Komuna - Mbështetje për ushtrime dhe pajisje	-	2,400	(1,200)	1,200
Ministria - Fondi i ringjalljes ekonomike	-	3,200	-	3,200
	<b>8,000</b>	<b>21,600</b>	<b>(25,200)</b>	<b>4,400</b>

Të hyrat e shtyra do të përdoren dhe njihen në të hyra dhe humbje për aktivitetet që do të vazhdojnë në vitin 2022 respektivisht në vitet pasuese bazuar në kontratat me Sponsoret dhe Donatorët.

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

### 10. FONDET

	31 dhjetor, 2021	31 dhjetor, 2020
<b>Fondi Operativ në Pasuri afatgjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Shtesat për pasurin afatgjate të furnizuar	23,450	0
Pakësimi për zhvlerësim	(1,563)	0
<b>Net Fondi Operativ në Pasuri të afatgjata për vitin</b>	<b>21,887</b>	<b>0</b>
<b>Fondi Operativ në Pasuri afatgjata në fund</b>	<b>21,887</b>	<b>0</b>
<b>Tepricat / (Mungesat) operative të vitit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Tepricat/ (Mungesat) operative të vitit	(3,095)	0
<b>Net tepricat / (Mungesat) operative të vitit</b>	<b>(3,095)</b>	<b>0</b>
<b>Net Fondi Operativ në fund</b>	<b>18,791</b>	<b>0</b>

### 11. TE HYRAT – FONDET E PRANUARA/NJOHURA

Të Hyrat	2021	2020
KK Prishtine Sub. 1	-	2,000
FNK- Pako 2020	-	710
FNK- MKRS-Pako 2020	-	1,200
Sponsorizim (Otrila & Auto Mita R)	23,450	667
KK Prishtinë Sub. 2	2,750	-
KK Prishtinë Sub. 3	1,600	-
KK Prishtinë Sub. 4	1,200	-
<b>Gjithsej të Hyrat</b>	<b>29,000</b>	<b>4,577</b>

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

### 12. SHPENZIMET

#### Shpenzimet e aktiviteteve

<b>Për vitin që mbaron me 31 Dhjetor</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Akomodim	-	952
Shpenz. e bankës	-	278
Pajisje sportive	2,750	620
Shpenz. e Pishinës	2,800	2,000
Shpenzimet e garave- pjesëmarrje	-	50
Transport	1,796	448
<b>Gjithsej shpenzimet e aktiviteteve</b>	<b>7,346</b>	<b>4,349</b>

#### Shpenzimet operacionale dhe administrative

<b>Për vitin që mbaron me 31 Dhjetor</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Shpenzimet operacionale dhe administrative	989	228
<b>Gjithsej Shpenzimet operacionale dhe administrative</b>	<b>989</b>	<b>228</b>

#### Shpenzimet e zhvlerësimit

<b>Për vitin që mbaron me 31 Dhjetor</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Shpenzimet e zhvlerësimit	1,563	-
<b>Gjithsej Shpenzimet zhvlerësimit</b>	<b>1,563</b>	<b>-</b>

#### Shpenzimet tjera

<b>Për vitin që mbaron me 31 Dhjetor</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Shpenzimet tjera	311	-
<b>Gjithsej Shpenzimet tjera</b>	<b>311</b>	<b>-</b>

<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	<b>10,209</b>	<b>4,577</b>
----------------------------	---------------	--------------

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

### 13. TE HYRAT DHE SHPENZIMET SIPAS DONATOREVE/ SPONSORVE

<b>Viti 2021</b>			
<b>Donatori</b>	<b>Të hyrat</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>Balanca</b>
<b>Donacionet/ Subvencionet</b>			
KK Prishtine Sub. 2	2,750	(2,750)	0
KK Prishtine Sub. 3	1,600	(1,600)	0
KK Prishtine Sub. 4	1,200	(1,200)	0
<b>Sponsorët</b>			
Sponsorizim (Otrila & Auto Mita R)	23,450	(1,563)	21,887
<b>Të tjera</b>			
Tjera	-	(3,095)	(3,095)
<b>Gjithsej</b>	<b>29,000</b>	<b>(10,208)</b>	<b>18,792</b>

<b>Viti 2020</b>			
<b>Donatori / Sponsor</b>	<b>Të hyrat</b>	<b>Shpenzimet</b>	<b>Balanca</b>
<b>Donacionet/ Subvencionet</b>			
KK Prishtine Sub. 1	2,000	(2,000)	0
FNK- Pako 2020	710	(710)	0
FNK- MKRS-Pako 2020	1,200	(1,200)	0
<b>Sponsorët</b>			
Auto Mita	667	(667)	0
	<b>4,577</b>	<b>(4,577)</b>	<b>0</b>

### 14. Ngjarjet pas përfundimit të datës së raportimit

Pas 31 Dhjetorit 2021 - data e raportimit deri në miratimin e këtyre pasqyrave financiare, nuk ka ngjarje rregulluese të pasqyruara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për shpalosjen në këto pasqyra financiare.



# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

---

### SHTOJCA 1

#### 1. Kontratat për sponsorizim me Spitali OTRILA Sh.P.K Prishtinë

##### 1.1. Kontrata për vitin 2021

Klubi ka një kontratë për sponsorizim me spitalin OTRILA (nr. i protokollit 3153/2021 datë 13.09.2021)

Qëllimi i lidhjes së Kontratës është dhënia e ndihmës/mbështetjes financiare nga spitali OTRILA SH.P.K. për K.S.U. "OTRILA" me qëllim të promovimit dhe lehtësimit të aktiviteteve që lidhen me sportet e ujit, përkatësisht sportin e notit, avancimin dhe masivizimin e notit tek fëmijët dhe të rinjtë në përgjithësi, e në veçanti, avancimin e notarëve/garueseve të klubit në paraqiten e tyre në gara të ndryshme vendore, regjionale dhe ndërkombëtare.

Vlera e kontratës është 8.000.00 Euro dhe vlejné për vitin 2021 me mundësi të zgjatjes.

Obligimet e përgjithshme të K.S.U. OTRILA janë të cekura në Nenin 4 dhe 8 të Kontratës.

Mjetet sipas Nenit 3 të Kontratës në vlerë prej 8,000.00 euro janë transferuar në llogarinë bankare të përfituesit K.S.U. OTRILA me datë 20 Shtator 2021.

Me date 25 Shtator 2021 K.S.U. OTRILA bazuar në nenin 8 të Kontratës me Sponsorin, dhe me aprovimin e Sponsorit ka transferuar në tërësi vlerën e pranuar prej 8,000.00 EUR tek "AUTO MITA" SHPK sipas Kontratës për shitblerjen e automjetit Kombi (Numri rendor: 2020419 dt. 31.12.2020) në emër të Avansit të dytë (në 2020 avansi i parë ishte transferuar në vlerë 8.000 Euro) për blerjen e automjetit të udhëtarëve Kombi Renault Trafic, me vlerë të përgjithshme përfshi dhe TVSH 23.450.00 Euro.

Automjeti "Kombi Renault Trafic" i cili do të jetë pronë e Klubit do të shfrytëzohet ekskluzivisht për bartjen e sportistëve të Klubit në stërvitje dhe gara.

##### 1.2. Kontrata për vitin 2020

Klubi ka një kontratë për sponsorizim me spitalin OTRILA (nr. i protokollit 199/2020 datë 09.12.2020).

Qëllimi i lidhjes së kontratës është dhënia e ndihmës/mbështetjes financiare nga spitali OTRILA SH.P.K. për K.S.U. "OTRILA" me qëllim të promovimit dhe lehtësimit të aktiviteteve që lidhen me sportet e ujit, përkatësisht sportin e notit, avancimin dhe masivizimin e notit tek fëmijët dhe të rinjtë në përgjithësi, e në veçanti, avancimin e notarëve/garueseve të klubit në paraqiten e tyre në gara të ndryshme vendore, regjionale dhe ndërkombëtare.

Vlera e kontratës është 8.000.00 Euro dhe vlejné për vitin 2020 me mundësi të zgjatjes.

Obligimet e përgjithshme të K.S.U. "OTRILA" janë të cekura në Nenin 4 dhe 8 të Kontratës.

Mjetet sipas Nenit 3 të Kontratës në vlerë prej 8,000.00 euro janë transferuar në llogarinë bankare të përfituesit K.S.U. OTRILA me datë 22 dhjetor 2020.

Me date 31 dhjetor 2020 K.S.U. OTRILA bazuar në nenin 8 të Kontratës me sponsorin, dhe me aprovimin e sponsorit ka transferuar në tërësi vlerën e pranuar prej 8,000.00 EUR tek "AUTO MITA" SHPK sipas Kontratës për shitblerjen e automjetit Kombi (Numri rendor: 2020419 dt. 31.12.2020) në emër të Avansit për blerjen e automjetit të udhëtarëve Kombi Renault Trafic, me vlerë të përgjithshme përfshi dhe TVSH 23.450.00 Euro.

Automjeti "Kombi Renault Trafic" do të shfrytëzohet ekskluzivisht për bartjen e sportistëve të Klubit në stërvitje dhe gara.

# Klubi i sporteve të ujit OTRILA Prishtinë – Kosovë

## Shënimet e Pasqyrave financiare për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Vlerat në Euro)

---

### 2. Kontrata për sponsorizim me "AUTO MITA R" SHPK

#### 2.1. Kontrata për vitin 2021

Klubi ka një kontratë për sponsorizim për vitin 2021 me "AUTO MITA R" SH.P.K. ("Sponsori") (e noterizuar nr. Rendor: LRP 6825/2021 date 08.12.2021).

Qëllimi i Kontratës është dhënia e ndihmës/mbështetjes financiare me qëllim të promovimit dhe lehtësimit të aktiviteteve që lidhen me sportet e ujit, përkatësisht sportin e notit, avancimin dhe masivizimin e notit tek fëmijët dhe të rinjtë në përgjithësi, e në veçanti, avancimin e notarëve/garueseve të klubit dhe paraqitjen në gara të ndryshme vendore, regjionale dhe ndërkombëtare.

Vlera e Kontratës është 6.000.00 Euro dhe vlejné për vitin 2021 me mundësi të zgjatjes. Kjo shumë është transferuar në llogari të K.S.U. OTRILA me datë 30 dhjetor 2021.

Obligimet e përgjithshme të K.S.U. OTRILA janë të cekura në Nenin 4 dhe 8 të Kontratës.

K.S.U. OTRILA me datë 30 dhjetor 2021 ka bërë transferin prej 5,450 Euro tek "AUTO MITA" SHPK në emër të avansit për blerjen e automjetit "Kombi Renault Trafic", (avansi paraprak i mjeteve të sponsorit në vlerë prej 2,000.00 Euro është transferua tek "AUTO MITA" SHPK me 14 korrik 2021), si dhe vlera prej 550,00 Euro është raportuar për shpenzime të aktivitetit të klubit.

#### 2.2. Kontrata për vitin 2020

Klubi ka një kontratë për sponsorizim me "AUTO MITA" SH.P.K. (e noterizuar nr. Rendor: LRP 7105/2020 date 23.dhjetor 2020).

Qëllimi i lidhjes së kontratës është dhënia e ndihmës/mbështetjes financiare nga sponsori "AUTO MITA" SH.P.K. me qëllim të promovimit dhe lehtësimit të aktiviteteve që lidhen me sportet e ujit, përkatësisht sportin e notit, avancimin dhe masivizimin e notit tek fëmijët dhe të rinjtë në përgjithësi, e në veçanti, avancimin e notarëve/garueseve të klubit që paraqiten në gara të ndryshme vendore, regjionale dhe ndërkombëtare.

Vlera e kontratës është 2.000.00 Euro dhe vlejné për vitin 2020 me mundësi të zgjatjes.

Obligimet e përgjithshme të K.S.U. OTRILA janë të cekura në Nenin 4 dhe 8 të Kontratës.

Mjetet sipas Nenit 3 të Kontratës në vlerë prej 2,000.00 Euro janë transferuar në llogarinë bankare të përfituesit K.S.U. OTRILA me datë 03 shkurt 2021.

Përfituesi gjatë vitit 2020 në emër të shpenzimeve të ndërlidhura me Kontratën në fjalë ka raportuar shpenzimeve për aktivitetet e klubit që ndërlidhen me nenet 4 dhe 8 të Kontratës në fjalë, në vlerë 666.64 Euro si dhe për vitin 2021 (deri me datën e përpilimit të këtij raportit, 15 korrik 2021) ka raportuar shpenzime 876.71 Euro.

Për më tepër Përfituesi K.S.U. OTRILA me datë 14 korrik 2021 ka bërë transferin e shumës shtesë të avansit prej 2,000.00 Euro tek "AUTO MITA" SHPK për blerjen e automjetit "Kombi Renault Trafic" për bartjen e sportisteve të Klubit në stërvitje dhe gara.

**Me datën 25 gusht 2021 Klubi ka pranuar automjetin Renault Trafic Passenger Zen dci 110 (Faktura nr 21-SHV01-IM4-490 dt. 25.gusht 2021, në vlerë prej 23,450 Euro i cili është regjistruar në emër të Klubit. Në evidencën kontabël është raportuar si Pasuri afatgjate – automjet dhe do të zhvlerësohet sipas normës prej 20% në vit.**